



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 9.1.2023

Nr: 6

Ora: 11:30

VENDIM

PËR

**PËRCAKTIMIN E PARTIVE POLITIKE QË DO TË PROPOZOJNË ANËTARËT DHE SEKRETARËT E KOMISIONEVE TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 29, pikat 1 dhe 4, nenit 183, pika 8, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Përcaktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ), që do të ngrihen dhe funksionojnë për zgjedhjet e datës 14 maj 2023, si më poshtë:
  - a) Dy anëtarë në çdo KZAZ propozohen nga Partia Socialiste e Shqipërisë,
  - b) Një anëtar në çdo KZAZ propozohet nga Partia Social Demokrate,
  - c) Dy anëtarë në çdo KZAZ propozohen nga Partia Demokratike,
  - ç) Një anëtar në çdo KZAZ propozohet nga Partia e Lirisë.
2. Anëtari i shtatë i KZAZ-ve do të propozohet në përputhje me rezultatet e shortit të hedhur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ndërmjet Partisë Socialiste të Shqipërisë dhe Partisë Demokratike.
3. Sekretari i KZAZ-së do të propozohet:
  - a) Nga partia Socialiste e Shqipërisë në KZAZ-të, ku Partia Socialiste ka propozuar zëvendëskryetarin e KZAZ-së;

Data: 9.1.2023 Nr: 6  
Ora: 11:30



“Për përcaktimin e partive politike që do të propozojnë anëtarët dhe sekretarët e KZAZ-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

- b) Nga Partia Demokratike në KZAZ-të, ku Partia Demokratike ka propozuar zëvendëskryetarin e KZAZ-së.
4. Partitë politike duhet të paraqesin kandidaturat për anëtarë të KZAZ-ve jo më vonë se data 29.01.2023.
  5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
  6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**